

UDHËZIM
Nr. 19, datë 30.8.2016

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 31, DATË 20.1.2001, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE
TETRAPLEGJIK”, TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, të pikës 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, të ndryshuar, bëhet 10.140 (dhjetë mijë e njëqind e dyzetë) lekë në muaj.

2. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, të ndryshuar, bëhet 10.650 (dhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2016 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2016, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

4. Udhëzimi nr. 23, datë 20.8.2015, i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2016.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Blendi Klosi